



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Štrpce

REPUBLICA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE KOMUNA E SHËTËRÇËS
IZLAZNI - DALËSE
01/Br.Prot. 02-030/01-3558/20
Nr. Prot. 1
Nr. i fq. 1
Datum 17.03.2020
ŠTRPCE - SHËTËRÇË

Shtabi emergjent ne komunën e Shtërpçës ne mbledhjen e mbajtur me 17.03.2020 ka shqyrtuar situatën ne komunën e Shtërpçës dhe ka vendosur te ndërmerren këto masa:

1. Te ndërpriten te gjitha transportet me kombi bus ne komunën e Shtërpçës;
2. Te reduktohet orari I punës prej 8 deri 20 të farmacive dhe marketeve ushqimore;
3. Pezullohen të gjitha aktivitetet e parapara nga Komuna e Shterpces (diskutime publike) aktivitetet kulturore, sportive etj;
4. Ndalohen tubimet e çfarëdo natyre si masë preventive ndaj përhapjes së virusit;
5. Te mbyllet tregu i gjelbër ne Shtërpce.
6. Pezullohen punët me palë në Komunën e Shtërpçës ne përjashtim rasteve urgjente;
7. Zyrtarët që punojnë me palë do të pajisen me mjete mbrojtëse dhe dezinfektuese;
8. Obligohen institucionet publike lokale që të lirojë nga puna zyrtarët me sëmundje kronike dhe shenja gripoze;
9. Obligohen marketet ushqimore, furrat dhe barnatoret që të lirojnë nga puna (me pagesë) punëtorët me sëmundje kronike dhe shenja gripoze;
10. Obligohen marketet ushqimore, furrat dhe barnatoret që të rrisin nivelin e higjienës dhe të dezinfektojnë hapësirat e punës;
11. Obligohen marketet ushqimore, furrat dhe barnatoret që gjatë orarit të punës të përdorin mjete mbrojtëse dhe dezinfektuese për secilin punëtor;
12. Inspektorati komunal vazhdon inspektimet në teren, për të inspektuar dhe ndaluar rritjen e çmimeve artificiale të produkteve;
13. Personat që kanë dyshime se janë infektuar me virus të vetë izoloohen dhe të kërkojnë ndihmë në linjën telefonike falas 038/200 80 800, pa pasur nevojë të paraqiten në QKMF, ekipi mobil do të intervenojë shpejtë;
14. Inspektorati Komunal do të kujdeset për implementimin e vendimit të Qeverisë që institucionet publike dhe ato private të lirojnë njërin prind nga puna brenda kësaj periudhe të pezullimit të procesit mësimor.
15. Te ndalohen punët ndërtimore ne Komunën e Shtërpçës deri ne njoftim te ardhshëm
16. Te reduktohet orari I punes ne institucione publike prej 08- 13, ne përjashtim te institucioneve shëndetësore.
17. Stacioni Policor në Shtërpce do të ofrojë asistencë sipas nevojës në zbatimin e vendimit të Qeverisë dhe vendimet te shtabit emergjent;



Kryetari i Shtabit Emergjent

Bratislav Nikolic